

DEKRET
Nr.508, datë 6.4.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË PËRBËRJEN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 28, pika 7, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të kryetarit të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zoti Bashkim Kopliku lirohet nga detyra e ministrit të Rendit Publik dhe mbetet zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave i ngarkuar me problemet e reformës ekonomike.

Neni 2

Zoti Rexhep Uka lirohet nga detyra e zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe të ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe emërohet ministër pa portofol për problemet e pushtetit lokal.

Neni 3

Zoti Ylli Vejsiu lirohet nga detyra e ministrit të Arsimit dhe ngarkohet me një detyrë tjetër.

Neni 4

Zoti Osman Shehu lirohet nga detyra e ministrit të Turizmit dhe ngarkohet me një detyrë tjetër.

Neni 5

Zoti Agron Musaraj emërohet ministër i Rendit Publik.

Neni 6

Zoti Petrit Kalakula emërohet ministër i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

Neni 7

Zoti Xhezair Teliti emërohet ministër i Arsimit.

Neni 8

Zoti Edmond Spaho emërohet ministër i Turizmit.

Neni 9

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me ligjin nr. 7704, datë 11.5.1993 të Kuvendit Popullor.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SALI BERISHA